

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, DHE FONDIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR POPULLSINË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”, hartohet mbështetur në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së bashkëfinancimit, e cila është miratuar me vendimin nr.420, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj hartohet jashtë programit analitik të akteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji i hap rrugë përfundimit të studimit ADHS, i cili:

- Realizohet në një kampion të madh dhe përfaqësues të popullatës dhe, si rrjedhojë, rezultatet e tij janë përfaqësuese për gjithë popullatën shqiptare;
- Ofron të dhëna të vlefshme demografike dhe shëndetësore për shumë grupmosha dhe kategori të rëndësishme të popullatës – të dhëna që nuk ofrohen nga të dhënat administrative dhe nga studime të tjera;

- Përfshin grupmoshat dhe kategoritë, si: fëmijët e moshës 0-5 vjeç, gratë shtatzëna, gratë e moshës riprodhuese, individët në moshë madhore të të dyja gjinive 15-59 vjeç.
- Siguron informacion për vlerësimin e programeve ekzistuese në vendin tonë.

2. Rezultatet e këtij studimi:

- Ofrojnë informacionin e nevojshëm jo vetëm për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por edhe për ministri të tjera, lidhur me hartimin e politikave dhe strategjive të reja, si dhe modifikimin e programeve ekzistuese lidhur me shëndetin dhe shërbimet shëndetësore dhe sociale që i ofrohen popullatës shqiptare;
- Ndihmojnë partnerët dhe drejtuesit e programeve për të planifikuar ndërhyrjet e mëtejshme në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së popullsisë shqiptare;
- Mundësojnë krahasimin e treguesve demografikë dhe shëndetësorë të popullsisë shqiptare në periudha kohore periodike. Gjithashtu, ADHS-ja do të mundësojë edhe krahasimin e të dhënave të vendit tonë me vendet e tjera;
- Kontribuojnë në pasurimin e bazës së të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me tregues të rëndësishëm demografikë dhe shëndetësorë, të cilët do të ndihmojnë edhe në raportimet periodike që Shqipëria do të bëjë mbi treguesit e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm (SDGs).

Të dhënat e studimit të parë të ADHS-së të realizuara në periudhën 2008- 2009 janë përdorur gjerësisht për hartimin e dokumenteve kryesore strategjike dhe politike, si: Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2016-2020; Programi Kombëtar për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Infektive në Shqipëri 2016-2020; Plani i Veprimit të Promovimit Shëndetësor 2017-2021; Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021.

Gjithashtu, të dhënat e përfutuara nga raundi i parë i ADHS-së janë reflektuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, miratuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 2016.

Institucione dhe organizata të rëndësishme partnere dhe mbështetëse, si UNFPA-ja, Organizata Botërore e Shëndetësisë, UNICEF-i, UN Women, UNDP-ja, SDC-ja, USAID-i, Banka Botërore dhe shumë organizata të tjera, të cilat operojnë në vendin tonë, i referohen gjerësisht të dhënave të ADHS-së në hartimin e programeve dhe planifikimin e ndërhyrjeve. Duke qenë se raundi i

parë i ADHS-së ka shumë kohë që është kryer (2008/09), përforcohet shumë nevoja e përditësimit të tyre, duke argumentuar edhe më shumë nevojën për ndërmarrjen e raundit të dytë të ADHS-së në vendin tonë.

ADHS-ja po zbatohet në kuadrin e një marrëveshjeje bashkëpunimi, ndërmjet agjencive ndërkombëtare që e mbështesin financiarisht: HAP, UNFPA, UNICEF, UN Women dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin e drejtuesit të procesit dhe të përfituesit kryesor, dhe dy institucioneve implementuese: Instituti Kombëtar i Statistikës (INSTAT) dhe Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Procesi shoqërohet dhe me ekspertizën e agjencisë së licencuar në këtë fushë, ICF International.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës. Procedurat e miratimit janë në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në pikën 1 të marrëveshjes së bashkëfinancimit, e cila është miratuar, në parim, me vendimin nr.420, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave, përcaktohen përkufizimet e saj.

Në nenin 2 përcaktohet se marrëveshja e bashkëfinancimit përbëhet nga kjo marrëveshje dhe shtojca nr.1, bashkëlidhur, e cila përshkruan programin.

Kontributi i donatorit në mbështetje të programit, masa e tij, si dhe mënyra e transferimit të kësaj shume, përcaktohet në nenin 3 të marrëveshjes.

Në nenin 4 përcaktohet se UNFPA-ja do të administrojë kontributin, në përputhje me rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat financiare të saj.

Mënyra e raportimit që UNFPA-ja do t'i paraqesë donatorit, si dhe afatet kohore përcaktohen në nenin 5 të marrëveshjes.

Nenet 6, 7 e 8 të marrëveshjes përcaktojnë vlerësimin e programit, mënyrën e auditimit, si dhe procedurat lidhur me pretendimet për korrupsion.

Në nenin 9 përcaktohet hyrja në fuqi, afati i vlefshmërisë, si edhe përfundimi i marrëveshjes.

Mënyra e zgjidhjes së çdo mosmarrëveshjeve, pretendimi që rrjedh nga/ose që lidhet me këtë marrëveshje, si edhe dispozitat përfundimtare të saj, përcaktohen në nenet 10 e 11 të marrëveshjes.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkërendim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Të tria ministritë janë shprehur dakord.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kryerja e plotë e studimit ADHS 2017-2018 kërkon një buxhet total prej 167 111 153 lekësh.

Duke marrë në konsideratë: Kontributet e partnerëve ndërkombëtarë (SDC/HAP, UNFPA, UNICEF, UN Women) dhe të institucioneve kombëtare (ISHP dhe INSTAT), shpenzimet e kryera, parashikimet e shpenzimeve deri në përfundimin me sukses të studimit (duke marrë parasysh edhe ndryshimet në kurset e këmbimit valutor nga të paktën tri monedha (CHF, USD, ALL), rezulton se fondi i pambuluar për përfundimin e ADHS-së është në total 300 000 USD (ose 33 500 000 lekë.)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mbulojë 22 500 000 (njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekë të këtij fondi të pambuluar, ndërsa UNFPA, në kuadër të marrëveshjes së bashkëfinancimit për këtë studim, krahas

kontributit të dhënë, merr përsipër të mbulojë diferencën prej 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekësh.

Ky projektligj nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të përmbushë me fondet e saj buxhetore mbulimin e fondit të nevojshëm prej 22.5 (njëzet e dy pikë pesë) milionë lekësh.

KËSHILLI I MINISTRAVE